



PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE E PROJEKTIT Qershor 2022

Përshkrimi i Projektit:

- Projekti është pjesë e Linjës 10 që lidh rrjetin hekurudhor të Kosovës me atë rajonal dhe Rrjetin evropian përmes Korridorit VIII dhe Korridorit X në Maqedoninë e Veriut. Kjo rrugë krijon një lidhje hekurudhore Beograd-Lapovë-Kraljevë (në Serbi) - Fushë Kosovë - Shkup (Maqedonia e Veriut) që shkon paralelisht me Korridorin X hekurudhor
- Financimi i Projektit bëhet nga tre burime të ndryshme kredia nga (BERZH dhe BEI) dhe Granti nga WBIF
- Projekti do të sigurojë të ardhmen afatgjatë të linjës, duke rritur gjithashtu sigurinë në trafik dhe duke lejuar përmirësime në shpejtësinë aktuale të funksionimit. Shpejtësia e projektuar është 120 km/h (70 km/h për 21 km të fundit)
- Inxhinieri lëshoi Njoftimin e Fillimit të Punimeve sipas SC 8.1 më 30 gusht 2019
- Shtojca nr.3 është nënshkruar më 08/12/2021 që rregullon të gjitha çështjet kontraktuale të pazgjidhura (kërkesat dhe mosmarrëveshjet) për arritjen e përfundimit të punimeve brenda buxhetit dhe duke caktuar një datë të re përfundimi në 30/12/2022 (zgjatja e kohës me 488 ditë) pa kosto shtesë për Punëdhënësin
- Më datë 30.06.2022 është nënshkruar Shtojca Nr.4 për Kontratën e Shërbimeve të mbikëqyrjes ndërmjet palëve me datën 01.06.2022, duke zgjatur ofrimin e Shërbimeve të mbikëqyrjes deri më 17.12.2022 dhe duke rishikuar në përputhje me rrethanat shumë maksimale të Kontratës.

Statusi Aktual dhe Progresi i punimeve:

- Vlera aktuale e kohës së kaluar të projektit është 85.0%
 - Progresi Fizik aktual I Linjë Kryesore arrin 61.3%, 48.75 km të linjës janë instaluar nga 79.57 km gjithsej në total
 - Absorbimi financiar aktual I Projektit 41.6%
 - Progresi Fizik aktual i Linjës Kryesore arrin 61.3%, 48.754 km të linjës janë instaluar nga 79.57 km gjithsej në total
 - Vonesa ndërmjet progresit financiar dhe atij fizik është për shkak të materialeve të superstrukturës, të cilat përfaqësojnë 48% të kostos totale të projektit. 72.7% e këtyre materialeve janë në vend
 - Vlera aktuale e Materialeve të Linjës në punishte është 79.1%
-

Punimet e kryera gjatë muajit raportues janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Nr	Pjesa / Stacioni	Fillimi	Fundi	Gjatësia (m)	Përshkrimi i punëve të kryera përgjatë këtij muaji
1	Fillimi- FK	246+888	248+200	1,312	E përfunduar, mungojnë rrethojat dhe drenazhimi
2	Stacioni i FK	248+200	249+600	1,400	Instalimi i Ndërrueses/Kthesës Nr 36 dhe pjesa e ndërmjetme e linjës kryesore të trasesë.
3	FK - Miradi	249+600	250+725	1,125	E përfunduar, mungon drenazhimi, rrethojat
4	Stacioni i Miradisë	250+725	252+723	1,998	Punime të dheut në zonën e Kthesave nr. 48, 49, 50, 51 dhe në pjesën e ndërmjetme të linjës kryesore të trasesë. Instalimi i Kthesës Nr 50
5	Miradi - Lipjan	252+723	261+338	8,615	E përfunduar, mungon drenazhimi, rrethojat
6	Stacioni i Lipjanit	261+338	262+282	944	E përfunduar, mungon linja e tretë dytësore, instalimi i ndërrueseve të reja, drenazhimi, rrethojave dhe dysHEMEJA e platformës
7	Lipjan - Bablak	262+282	270+859	8,577	E përfunduar, mungon instalimi i plotë i ndërrueseve të reja, drenazhimit dhe rrethojave
8	Stacioni i Bablakut	270+859	271+606	746	Rrjeti i kullimit dhe shtresa e sipërme mbrojtëse
9	Bablak - Ferizaj	271+606	280+731	9,126	Përfundimi i punimeve të dheut dhe instalimi i vijës së re të trasesë (740 m)
10	Stacioni i Ferizajt	280+731	281+937	1,205	Përfundimi i punimeve të dheut për Linjën 1 dhe 3, muri 16RB dhe punime në platformën RHS
11	Ferizaj - Gurëz	281+937	288+994	7,057	Në progres, mungojnë 1.8 km, drenazhimi dhe rrethojat
12	Stacioni i Gurëzës	288+994	289+778	784	E përfunduar, mungon drenazhimi, rrethojat dhe dysHEMEJA e platformës
13	Gurëz - Kacanik	289+778	299+740	9,962	-
14	Stacioni i Kaçanikut	299+740	300+608	868	Ura 15 është demoluar më 08/06/2022 dhe u vendos sërish më 30/06/2022 pas ekzaminimit të gjendjes dhe provave për heqjen e thumbave, pastrimin me rërë dhe lyerjen
15	Kacanik - HiE	300+608	311+174	10,566	Për 3,417 m, kanë vazhduar punimet për mbrojtjen e pjerrësisë së përhershme në portalet e tunelit 6 dhe 7, 120 m të Mbështetjes së përkohshme të tunelit 7. Përfundimi i punimeve të dheut nga 307+700 deri në 309+940 dhe instalimi i superstrukturës në Linjë.
16	Stacioni i Hanit të Elezit	311+174	311+954	781	Muri 38R dhe 39R, vazhdimi i punimeve në platformë RHS dhe instalimi i Kthesës Nr 10

Nr	Pjesa / Stacioni	Fillimi	Fundi	Gjatësia (m)	Përshkrimi i punëve të kryera përgjatë këtij muaji
17	HiE - Fund	311+954	313+711	1,756	Përfundimi i punimeve të dheut, kalimi i përkohshëm nr 31, montimi i superstrukturës 1760m

Gjatësia Totale = 66,823

Kontraktori ka sjellë traversa të betonit të parandera me gjatësi 2.60 m dhe 2.40 m (së bashku me sistemin e fiksimit tashmë të montuar/instaluar) në një numër total prej 129,633 copë (106,676 dhe 22,957) copë që përfaqësojnë 99.77% të sasisë totale. Në muajin aktual nuk janë sjellë traversa betoni nga Kontraktori.


Nga gjithsej 73 Ndërrueseve/Kthesave të të dy llojeve (UIC 60 dhe S-49), 41 copë të kompletuara janë dorëzuar në total dhe janë të deponuara në zonën e stacionit Miradi. Në total janë instaluar 16 Ndërruese.

Ndërtimi i murit mbajtës	Shtresa e sipërme mbrojtëse
	
Vendosja e armaturës për ndërtimin e platformës në Stacionin e Hanit të Elezit	Testimi i ankerëve duke përdorur platformën ngritëse në portalin verior të tunelit 6
	
Ndërtimi i Gabioneve pranë C114	Ndërtimi i linjës hekurudhore në Han të Elezit



Ura e ndërtuar Br. 33

Gërmimi i linjës kryesore



Ndërtimi i mbështetjes së përkohshme në
Tunelin 7

Instalimi i armaturës në murin 41 Djathtas



Ndërtimi i murit 41 Djathtas

Linja hekurudhore e përfunduar në Han të
Elezit



Me shumë Respekt,

Zijadin Isufi
Udhëheqës i NjIP-PIU